


PROCEDURA E LËSHIMIT TË GARANCISË

1. Subjekti ekonomik aplikon në bankë apo institucionin financiar jo bankë, partner i programit për kredi.

Institucionet Financiare Pjesëmarrëse



2. Institucioni financiar do të vlerësojë aplikimin dhe nëse plotësohen kushtet e pranueshmërisë, por ka mungesë kolaterali, dërgon aplikimin për mbulim me garanci tek **Fondi Shqiptar i Garancisë**.
3. Kërkesa do të shqyrtohet në një kohë të shkurtër. **Fondi Shqiptar i Garancisë** mund t'i kërkojë bankës çdo informacion shtesë që konsiderohet i nevojshëm për përfundimin e aprovimit. Pas aprovimit, subjekti përfitues i kredisë paguan tarifën e garancisë për **Fondin Shqiptar të Garancisë**.
4. **Fondi Shqiptar i Garancisë** lëshon garancinë e kredisë për bankën ose institucionin financiar jo bankë.
5. Banka ose institucioni financiar jo bankë, nënshkruan kontratën e kredisë me përfituesin e kredisë.



Informacion i Mëtejshëm

Për më shumë informacion, ju lutemi mos hezitoni të kontaktoni:

NJËSIA E MENAXHIMIT TË PROGRAMIT (PMU)
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË



Blvd. "Dëshmorët e Kombit",
1001, Tiranë, Shqipëri



+355 4 22366811



+355 4 22366449



info@prodaps.al



www.prodaps.al

FONDI SHQIPTAR I GARANCISË

Garanci deri në

60%

për financimin e biznesit tuaj!



PROGRAMI ITALO-SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME NË SHQIPËRI

ÇFARË ËSHTË FONDI SHQIPTAR I GARANCISË?

Fondi Shqiptar i Garancisë është një instrument financiar i krijuar nga Qeveria Italiane dhe Qeveria Shqiptare në kuadër të Programit Italo-Shqiptar për Zhvillimin e SME-ve në Shqipëri, i cili mundëson ofrimin e garancive në trajtën e kolateralit për të nxitur kreditimin nga ana e institucioneve financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (SME), që kanë vështirësi në qasjen e kredisë bankare, sepse nuk kanë garanci të mjaftueshme.

Fondi Shqiptar i Garancisë, në praktikë, zëvendëson garancitë që zakonisht kërkohen për të marrë kredi nga bizneset mikro, të vogla dhe të mesme, duke ulur rrezikun në shumën e garantuar.

Me këtë garanci kredie SME-të kanë mundësi të marrin kredi më të lira se ato të tregut pa garanci shtesë, për pjesën e garantuar nga Fondi.

CILAT BIZNESE PËRFITOJNË?

Të gjitha subjektet: persona fizikë ose juridikë, të cilët zotërojnë ose përfaqësojnë ndërmarrje mikro, të vogla ose të mesme (SME) dhe që aktualisht ushtrojnë një aktivitet sipërmarrjeje ose që dëshirojnë të fillojnë një aktivitet (start-up) në Shqipëri, që i përkasin sektorëve të ndryshëm si bujqësia, agroindustria, peshkimi dhe akuakultura, industria prodhuese e përpunuese, teknologjia e komunikimit dhe informacionit, prodhimi natyror i energjisë, transporti, turizmi dhe shërbimet.



KRITERET E PRANUESHMËRISË

Vetëm ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme që plotësojnë kriteret dhe kushtet e pranueshmërisë nga linja e kredisë së Programit Italo-Shqiptar për Zhvillimin e SME-ve në Shqipëri kanë të drejtë të përfitojnë nga **Fondi Shqiptar i Garancisë**.

Në veçanti, për t'u kualifikuar për mbështetje nga Fondi Shqiptar i Garancisë, SME-të duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- Shoqëria është e regjistruar në Shqipëri;
- Jo më pak se **51%** e kapitalit të shoqërisë zotërohet nga shtetas shqiptarë;
- Qarkullimi vjetor jo më i lartë se **10 milion Euro**;
- Numri i punonjësve jo më i lartë se **250**-të.



KUSHTET E LËSHIMIT TË GARANCISË

Fondi Shqiptar i Garancisë mund të përdoret vetëm për garantimin e kredive që financohen, në kuadër të Programit Italo-Shqiptar për Zhvillimin e SME-ve në Shqipëri, nëpërmjet bankave apo institucioneve financiare jo bankë, partnere të programit.

Garancitë e kredisë lëshohen për kredi për financimin e projekteve të investimeve të SME-ve që janë të lidhura me blerjen e makinerive, pajisjeve dhe shërbimeve me origjinë Italiane.

Fondi i Garancisë do të garantojë bankat apo institucionet financiare jo bankë, partnere të programit, duke ju mbuluar deri në **50%** të riskut potencial në shlyerjen në afat të kredisë për projektet standard dhe deri në **60%** për projektet prioritare të SME-ve.

Shuma maksimale e garancisë për SME-të:

Lloji i kredisë	Shuma Minimale e Kredisë	Shuma Maksimale e Kredisë	Shuma Maksimale e Garancisë	Mbulimi me Garanci në %
A	€ 50,001	€ 500,000	€ 200,000	Deri në 50%
B	€ 50,001	€ 500,000	€ 200,000	Deri në 60%
C	€ 15,000	€ 50,000	€ 30,000	Deri në 60%

Përcaktimi: A-Projekt Standard, B-Projekt Prioritar, C-Projekt i Vogël

Norma maksimale e interesit që aplikohet është

deri në
3%
për kreditë në
Euro

deri në
4%
për kreditë në
lek

Kushtet e ripagimit të kredisë janë nga **3 - 8 vjet** dhe perioda "Grace" ku paguhet vetëm interesi, nga **1 deri në 2 vjet**.

TARIFA E GARANCISË

Subjekti ekonomik përfitues do të paguajë një tarifë fillestare prej **1% në vit** të llogaritur mbi shumën vjetore të garancisë së vendosur për çdo kredi të garantuar.